

Rregullore e Promocionit “Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola ” të organizuar nga “Coca-Cola Bottling Shqipëria” (CCBS)

1. Subjekti organizues i promocionit **“Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola”** është shoqëria Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk. (CCBS), NUIS J61901061H, me seli në adresën: Rr. Kombëtare Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë.
2. Promocioni **“Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola”** do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Shorteu për përzgjedhjen e 1 fituesi **“Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola”**, do behet me datë **21 Korrik 2025** dhe periudha e grumbullimit të pikëve do të jete filluar nga data 26 Maj deri ne daten 20 Korrik 2025
4. Mund të marrin pjesë në promocion **“Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola”** të gjithë personat fizikë me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë mbi 18 Vjec, që prej 26 Maj deri ne daten 20 Korrik 2025, të cilët do të blejnë produktet Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero, kanaçe 330 ml, Shishe 400 ml, Shishe 900 ml dhe Shishe 1500 ml. Produkte të prodhuar nga Coca-Cola Bottling Shqipëria shpk.
5. Nuk mund të marrin pjesë në promocionin **“Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola”** punëmarrësit e subjektit organizues, titullarët e distributorëve të autorizuar, apo punëmarrësit e pikave të shitjes ku tregëtohen produktet e CCBS, familjarët e personave të mësipërm (bashkëshort, bashkëjetues, prindër, fëmijë, vëllezër dhe motra).
6. Produktet e CCBS të përfshira në këtë promocion do të shiten me çmimin normal të tregut. Çmimi i rekomanduar i tregut për keto produkte gjendet në tabelën me poshte:

Produktet pjesë e promocionit	Çmimi i rekomanduar për konsumatorin /copë (Pa TVSH)	Çmimi i rekomanduar për konsumatorin /copë (Me TVSH)
Coca-Cola Zero Sheqer 0.33L	66.67 Lekë	80 Lekë
Coca-Cola Shije Origjinale 0.33L	66.67 Lekë	80 Lekë
Coca-Cola Shije Origjinale 0.40 L	66.67 Lekë	80 Lekë
Coca-Cola Zero Sheqer 0.40 l	66.67 Lekë	80 Lekë
Coca-Cola Shije Origjinale 0.90 L	82.60 Leke	100 Leke
Coca-Cola Zero Sheqer 0.90 L	82.60 Leke	100 Leke
Coca-Cola Shije Origjinale 1.5 L	133.3 Leke	160 Leke
Coca-Cola Zero Sheqer 1.5 L	133.3 Leke	160 Leke

Për të marrë pjesë në promocion konsumatorët duhet të bëjnë blerje një nga produktet e përmendura në tabelën më lart, të hyjë në faqen e website www.coca-cola.com pa kosto. Pasi kanë hyrë në faqe duhet të krijojnë një llogari me të dhënat e tyre. Më pas duke përdorur kodin me 8 karaktere të cilat gjenden poshtë hapses se kanaces ose poshtë hapses se shisheve mund të mbedhin pike dhe të aplikojnë për të bërë pjesë e shorteut. Një kanaçe ka vlerë 10 pikë, dhe një shishe ka vlerë 15 pikë. Për të bërë pjesë e shorteut konsumatori duhet të mbledhi 50 pike. Shoqëria e cila do të menaxhojë dhe monitorojë website do të jetë Agjensia Ogilvy SHPK adresa: Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, kat 4 Tiranë 1001.

Mekanika e promocionit “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” konsiston në një kombinim të formulave “Bëj blerje të një produkti Coca-Cola, hyr në faqen e website, mblidh pike përmes kodeve nën tape dhe aplikoj për të bërë pjesë e shorteut “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” për të fituar një udhëtim turistik për 4 persona në Antalya, Delphin Imperial Hotel 5*

Për të marrë pjesë në promocionin “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” dhe për të fituar çmimet e vëna në dispozicion nga CCBS, pjesëmarrësit duhet të ndjekin udhëzimet vijuese të përcaktuara në këtë rregullore:

- Konsumatori duhet të bëjë blerje një nga produktet Coca-Cola pjesë e kësaj Loje Promocionale.
- Konsumatori duhet të hyjë në faqen e website www.coca-cola.com dhe të krijojë një llogari.
- Konsumatorët duhet të plotësojnë të dhënat e kërkuara në website www.coca-cola.com dhe përmes kodeve nën kanace ose nën tapën e shisheve të mbledhin pikë. Pasi ka grumbulluar 50 pikë mund të aplikojë për të bërë pjesë e shorteut.
- Konsumatori duhet të jetë mbi 18 vjeç.
- Loja Promocionale do të jetë e vlefshme: Nga data 26 Maj 2025 deri në datën 20 Korrik 2025.
- Hedhja e shorteut për të shpallur 1 fitues do të bëhet **ne datën 21 Korrik 2025 (ditën e Hënë) në orën 10:00**, në praninë e një noteri publik të autorizuar nga CCBS.
- Fituesi fiton një udhëtim turistik për 4 persona në Antalya, Delphin Imperial Hotel 5*.
- Fitues do të jetë personi i parë i cili do të zgjidhet në mënyrë rastësore. Noteri do të certifikojë me anë të një procesverbali, i cili do të mbahet në momentin e hedhjes së shorteut dhe përzgjedhjes së fituesit. Ky procesverbal do të firmoset nga personat e pranishëm të cilët do të jenë: një punonjës i autorizuar nga CCBS, një punonjës i autorizuar nga Agjencia Ogilvy SHPK adresa: Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, kat 4 Tiranë 1001, një punonjës i autorizuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave të Fatit, një punonjës i autorizuar nga Tatimet si dhe Noteri Publik dhe ose As/Noterit të autorizuar nga CCBS.
- Ditët e pushimit do të zëvendësohen nga dita pasardhëse.
- Vendi ku do të hidhet shorteu për zgjedhjen e fituesit është pranë Agjencia Ogilvy SHPK adresa: Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, kat 4 Tiranë 1001.
- Mënyra e zgjedhjes së fituesit do të jetë rastësore nga sistemi. Do të përzgjidhen në mënyrë rastësore 10 persona për shorte dhe fitues të një shorteu konsiderohen personi parë numrat e tjerë do të mbahen rezervë.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij promocioni, konsumatorët do të kenë mundësinë të fitojnë në total:

- 1 dhuratë: udhëtim turistik për 4 persona në Antalya, Delphin Imperial Hotel 5*
- Vlera totale e dhuratave është si më poshtë:

• Pershkrim i dhurates	Sasi	Alliance Travel (Agjencia)	
		Cmim/person (Eur, pa TVSH excl.)	Total (Eur, pa TVSH excl.)
Udhëtim në Antalya (2 dhoma të ndara 4 persona) Delphin Imperial Hotel 5*	1	1,800 Euro/person	7,200 Euro
Te përfshira në cmim: ✓ Fluturim direkt charter			

✓ Akomodimi ne hotel per 6 nete/7dite			
✓ Ultra Gjithëpërfshirës			
✓ Transport i përfshire Aeroport-Hotel-Aeroport			
Total			7,200 Euro

Komentet:

Tirana – ANTALIA AYT | 29.08.2025 | 04.09.2025 | 6 Netë(s) | 2 Dhoma(s) | 4 Persona
 Delphin Imperial Hotel 5*- 1800 eur personi / akomodim ne dhome dopio superiore / te gjitha te perfshira
 2 dhoma / 4 persona ne moshe madhore

*Çmimi **nuk eshte i** konvertueshem në para.

7. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në promocionin “Loja Promocionale Coke&Meal” është rreth ~2 milion.

Shpërndarja e dhurates do të bëhet në ambientet e CCBS. Fituesit mund të tërheqin dhuratën nga e Hëna në të Premte, nga ora 10:00-16:00 nga data 21 Korrik 2025 deri në 31 Korrik 2025. Tërheqja e dhuratës mund të kryhet vetëm me paraqitjen e dokumentit të identifikimit të fituesit. Fituesi duhet të firmosi në momentin e marrjes së dhuratës procesverbalin e marrjes në dorëzim të dhuratës si dhe faturën përkatëse. Fituesi do të përfitojë dhuratën brënda një harku kohor prej 10 ditë pune nga data e shpalljes fitues. Nëse Fituesi nuk do të paraqitet, brënda afatit ditor prej 10 ditë pune, për të tërhequr dhuratën, ai pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj CCBS, lidhur me dhuratën e përfituar, pasi ai humb të drejtën si fitues i këtij Promocioni dhe CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës të përzgjedhur në të njëjtën ditë me fituesin që ka refuzuar të tërheqë dhuratën.

Pjesëmarrës në shorte do të jenë të gjithë konsumatorët që kanë mbledhur pike dhe kanë aplikuar për tu bere pjese e lojes promocionale Coca-Cola në website gjatë periudhës respektive: 26 Maj 2025 deri 20 Korrik 2025.

Fituesi do të:

- Njoftohet me email brënda ditës së hedhjes së shorteut. Nëse fituesi nuk përgjigjet në emailin e derguar brenda 5 diteve apo emaili nuk i shkon, atëherë CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës.
- Në rast se fituesi nuk përgjigjet në email pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim lidhur me humbjen e të drejtës si fitues i këtij Promocioni.
- Duhet të japë me email kredencialet e plota si: emër, mbiemër, atësi, numrin e kartës së identitetit, qytetin dhe adresën e saktë të banimit.
- Të gjitha të dhënat personale do të përpunohen nga CCBS vetëm për qëllimin e këtij promocioni, vetem pas miratimit të kushteve dhe termave për përpunimin e ketyre të dhenave nga ana e aplikuesve në llogarinë e krijuar e sipas rregullores perkatëse dhe do të shkatërrohen brënda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhurates, sipas ligjit në fuqi, duke mos lejuar

humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen te të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara. Të dhënat personale të mbledhura nga CCBS dhe Agjensia Ogilvy SHPK me seli ne adresen: Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, kat 4 Tiranë 1001 në kuadër të këtij promocioni dhe sipas kushteve të kësaj rregullore, do të trajtohen në përputhje me Ligjin “**Nr.124/2024** “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- e) CCBS nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm financiar apo jofinanciar (përfshirë dëmin apo fitimin e munguar) që mund të rezultojë si pasojë e pjesëmarrjes në promocionin “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” përjashtuar përgjegjësinë ligjore të CCBS.
- f) Të gjithë pjesëmarrësit në lojën promocionale duhet të jenë në dijeni se të dhënat e fituesve në këtë lojë promocionale do të shpallen në faqen zyrtare të lojes promocionale “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” dhe bien dakord që të dhënat e tyre të jenë publike në faqen zyrtare pas shpalljes së fituesit me date 21 Korrik 2025.
- g) Në rast gabimesh në stampim apo të çdo parregullsie tjetër të hapeses se kanaces promocionale, përfshi këtu fshirjen e pjesshme apo modifikimin e kodeve sipas vlerësimit të vetëm të subjektit organizues, subjekti organizues CCBS apo çdo partner i autorizuar, nuk do të jetë përgjegjës apo i detyruar për dhënien e dhuratës. Pjesëmarrësit në këtë promocion nuk kanë të drejtë të kërkojnë çmim në sasi më të madhe, apo çmim të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga subjekti organizues i fushatës sipas kësaj rregulloreje. Çmimi i mësipërm nuk është i konvertueshëm në para. Duke marrë pjesë në këtë promocion, pjesëmarrësit detyrohen të respektojnë këtë rregullore.
- h) Promocioni “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” mund të ndërpritet në rast force madhore dhe/ ose Fatkeqesie Natyrore (rrethana të cila Shoqëria nuk mund t'i kishte parashikuar apo influencuar), përfshirë pamundësinë e CCBS për të vazhduar promocionin “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” për arsye që nuk varen nga vullneti i saj. CCBS do të informojë konsumatorët me mjetet e duhura në rast ndërprerjeje të promocionit “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” duke dhënë edhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në raste të tilla, CCBS nuk do të ketë detyrimin për të dëmshpërblyer pjesëmarrësit për çdo shpenzim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në promocion.
- i) Promocioni “**Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola**” është një ofertë që i drejtohet publikut dhe bazohet në nenet 661, 665, 667 paragrafi i parë dhe i tretë, 670 e 671 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Organizimi i promocionit **Loja Promocionale Ndaj një Coca-Cola** bëhet në përputhje me Ligjin 155 /2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 75/2018 datë 25.10.2018 si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017 “Përcaktimin E Mënyrave, Formave, Kriteve Dhe Rregullave Për Organizimin E Lojërave Të Fatit Promocionale”. Personat që sipas parashikimeve të kësaj rregullore kanë të drejtë të tërheqin çmimet e vëna në lojë, nëse hasin pengesë në tërheqjen e tyre mund të paraqesin çdo ankesë apo informacion në numrin e tel: +35545606060 ose ne adresën e e-mailit: info@cocacola.al.
- j) Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero janë marka të regjistruara të “The Coca-Cola Company”.
- k) Këto rregulla do të botohen pjesërisht në materialet promocionale dhe plotësisht në website (www.coca-cola.com).